



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 540/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Shtime, paraqitur Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), për shkak të manipulimeve me vota gjatë procesit të numërimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK, dega në Shtime, në të cilën pretendohet se në mënyrë urgjente të filloj rinumërimi i të gjitha kutive me vota në territorin e KK Shtime. Komisionerët në mënyrë të organizuar i kanë shpërdoruar fletëvotimet ku janë dëmtuar një pjesë e Asambleistëve të cilëve nuk iu është numëruar as vota e tyre as e familjarëve dhe me këtë rast 90% të kandidatëve për Asamble Komunale në Shtime kërkojnë rinumërimin e secilës kuti të votimeve si dhe në këtë kërkesë është bashkangjitur: Lista me nënshkrime të Kandidatëve për Asamblenë Komunale në Shtime – LDK, Deklaratat – Kërkesat individuale të kandidatëve për AKSH nga radhët e tyre, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, dhe manipulimit të votave, gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet lokale të 3 Nëntorit 2013.

- Në Qendrën e Vendvotimit (QV), 2206e, Godanc – Shtime në pikat VV.nr 1, VV.nr 2, VV.nr 3 në këtë vendvotim janë bërë keqpërdorime të votave në mes të kandidatëve për këshilltar të kuvendit komunal.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) , 2201X, theksohet se votat e familjarëve të tij nuk janë regjistruar dhe se ka pas shumë vota të dëmtuara për kandidatë.

- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X, pretendohet ka ndodhur parregullsia më e madhe përderisa kryesuesi nuk ka sjellur raport, as nuk lajmërohet e në këtë vendvotim kanë votuar familja si vet kandidati, ndërsa rezultati është me 0 vota, prandaj kërkohet rinumërimi
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2202E, pretendohet se dyshohet në numërimin e votave sepse nuk është konfirmimi i saktë nga komisionerët e LDK-së.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2207E, nr VV1 VV 2 ka pasur keqpërdorime të fletëvotimeve pasi që në këto vendvotime ka pas votat e familjarëve dhe si anëtarë i LDK-së kërkon rinumërimin e votave.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X nr.04, Shtime numri i votave të cilat janë pritur janë bërë të pavlefshme duke votuar edhe ndonjë kandidatë ose parti tjetër kërkohet rinumërimi i votave.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X duhsohet në numrin e votave.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201e Naim Frashëri n.1, 2, 3, 4, 5, 6, dyshohet në numërim të votave.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X Dyshohet se votat e familjarëve janë qitur në FPR ose janë shpallur të pavlefshme.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X kërkohet rinumërimi i votave sepse nuk rezultojnë as votat e familjarëve.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2204E, nuk janë numëruar votat e familjarëve prandaj kërkohet rinumërimi i tyre.
- Në Qendrën e Vendvotimeve (QV) 2203E Raçak, votat e tyre nuk janë numëruar saktë prandaj kërkohet rinumërimi i tyre.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201E, sipas deklaratave të familjarëve dhe miqëve pas votimit ka pasur më pak vota.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) në Shtime, dyshohet që votat nuk janë numëruar mirë dhe drejt, janë numëruar drejt, andaj kërkohet një rinumërim i votave.
- Në Qendrën e Vendvotimeve (QV) në Muzeqin – Shtime, ankesa bazohet në mos numërimin e votave te familjarëve.

- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2201X nr.006 shkolla fillore Emin Duraku , të gjitha votat e sigurta janë bërë të pavlefshme deri ne 15 vota, prandaj kërkohet rinumërkohet rinumërimi.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2206e, nr. 01 – Godancë është bërë parregullsi e madhe sepse iu kanë humbur votat të gjithëve përveq anëtarit nga Godanci si dhe kërkohet rinumërimi.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2203e, nr.002 Raçak është bërë pparregullsi sepse në vendin e lindjes së tij ka pasur vetë 4 vota dhe 50 janë të pavlefshme.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2212e, nr 01, është bërë parregullsi sepse votat e sigurta të familjarëve nuk figurojnë në formularët e vëzhguesvetë tyre prandaj kërkohet rinumërimi i tyre.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) fsh.Gjyrkovic 03, kanë votuar miqtë dhe familjarët të cilët e kanë konfirmuar se janë 20 personpersona që e kanë votuar ndërsa nuk ekziston asnjë votë.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) VV.02, kanë votuar familjarët dhe votat e tyre nuk janë numëruar drejt , gjithashtu ka pasur njerëz të tjerë të PDK-së që kanë qenë të dyshimtë dhe kanë bërë trusni.
- Në Qendrën e Vendvotimit (QV) 2209e , VV.1, VV.2, janë bërë keqpërdorime në numërimin e votave në mes kandidatëve, sepse kanë votuar njerës familjar shumë të sigurt.

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, lidhur me ndodhjen dhe evidentimin e parregullsive në Qendrat e Votimit 2206e, 2201X, 2201X.VV.03 , 2202E, 2207E VV.1, 2201X VVnr004, 2201X, 2201E nr 1,2,3,4,5,6, 2206E VV1,2,3, 2202E VV.1,2,3,4, 2207E VV1,2, 2201X VV03, 2201X, 2204E, 2203E, 2201E, 2201X-006, 2206e-nr01, 2203E – nr.002, 2212E nr.01, VV.03, 2209e VV. RR.2 , janë të pabazuara, nga shkak se nga parashtruesi i ankesës nuk është bashkangjitur asnjë provë ankesave të parashtruara, me të cilat do të mund të administroheshin lëndët, ose do të mund të verifikohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar parregullsi nga vëzhguesit e subjektit të lartcekur, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara.Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 540/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.